

VENDIM
Nr. 44, datë 7.4.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KISI-BIO-ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KACNI”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”; 5 pika 1 germa “a”; 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.4.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, me fuqi totale 3,87 MW,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 9, pika 1- Formati i aplikimit nuk është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 2-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 3- Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar pjesërisht.
- Neni 9, pika 4.1.1-Të dhëna specifike për HEC janë plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 4.1.2-Të dhënat për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin janë plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4.1.3-Dokumentacioni teknik dhe grafik është plotësuar pjesërisht.

- Neni 9, pika 4.1.4-Dokumentacioni tekniko-ekonomik është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.5-Leje nga institucione të tjera, është plotësuar tërësisht.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kacni” me fuqi totale 3,87 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti